



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2024:063446
Datë: 19.02.2026
Numri i dokumentit: 08498353

K.Dh.Shk.II.nr.1132/25

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “BAAF” SH.P.K., me seli në fshatin Lutogllavë, Prizren, me NUI: 811915985, me autorizim e përfaqëson Murat Paçarada avokat nga Prishtina, kundër debitorit Ministria e Mbrojtjes-Qeveria e Kosovës, me seli në Prishtinë, me autorizim e përfaqëson Fitore Byqmeti nga Avokatura Shtetërore, sipas dokumentit të besueshëm përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1334/23 të datës 02.06.2025, me datën 19.02.2026, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Ministria e Mbrojtjes-Qeveria e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1334/23 të datës 02.06.2025 **VËRTETOHET**.



A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me Aktvendimin KPPP.nr.1334/23 të datës 02.06.2025, në dispozitiv e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Ministria e Mbrojtjes-Qeveria e Kosovës, me seli në Prishtinë, ashtu që Urdhëri Përmbartimor P.nr.371/23 të datës 07.08.2023, të Përmbartuesit Privat Rushit Hoxha mbetet në fuqi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar debitorit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit, të anulohet Aktvendimi KPPP.nr.1334/23 të datës 02.06.2025, ashtu që të anulohet urdhëri përmbartimor P.nr.371/23 të datës 07.08.2023, të përmbartuesit privat Rushit Hoxha.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitorit, duke kundërshtuar pretendimet e debitorit dhe ka propozuar që të refuzohet ankesa e debitorit si e pa bazuar dhe të mbete ne fuqi aktvendimi i gjykatës shkallës së parë.

Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 01/2023 e datës 20.06.2023, që të paguaj për shumën e borxhit prej 1.130,116.63€, me kamatë ligjore prej ditës së arritjes deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet të procedurës e përmbartimit.

Përmbartuesit privat Rushit Hoxha, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm– Faturës Nr. 01/2023 e datës 20.06.2023 e cila paraqet dokument përmbartuese në bazë të nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar se dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit është lejuar përmbartimi nuk është ka tipare të përmbartueshmërisë dhe se si e tillë nuk paraqet dokument të besueshëm, pasi që sipas kontratës me nr. Prokurorimi 21700/022/111 afati i dorëzimit për dorëzim ka qenë 15.12.2022 duka bazuar në nenin 2 par. 2.1 d të kontratës ndërsa kontrata është nënshkruar me datë 05.07.2022 dhe nxjerrja e urdhër blerjes është bërë me datën 05.07.2022 pra afati i dorëzimit ka qenë me datën 15.12.2022, pra janë të paraqitura ditët me vones sipas lifermeve nga raporti e pranimit dhe komisioneve të pranimit. Andaj ka propozuar që ta pranoj prapësimin e debitorit dhe të anuloj urdhërin përmbartimor dhe të obligoj kreditorin që ti bartë shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar me asnjë prove dhe dokumenti përmbartë të gjitha elementet e një dokumenti të besueshëm dhe se nuk ka asnjë vonesë me përgjegjësi të kreditorit, andaj ka propozuar që të mbetet në fuqi urdhëri përmbartimor.

Lidhur me prapësimin, Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me Aktvendimin KPPP.nr.1334/23 të datës 02.06.2025, në dispozitiv e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Ministria e Mbrojtjes-Qeveria e Kosovës, me seli në Prishtinë, ashtu që Urdhëri Përmbartimor P.nr.371/23 të datës 07.08.2023, të Përmbartuesit Privat Rushit Hoxha mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbartimore. Gjykata e shkallës së parë në rastin e vendosjes, me të drejtë ka konstatuar se në shkresat e lëndës konstatohet se pretendimet në prapësim të pa qëndrueshëm, sepse i plotëson kushtet ligjore në kuptim të nenit 29 dhe 37 të

LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhërit të përmbartimit të përcaktuar me nenin 69 dhe 71 të LPP-së, gjithashtu kjo faturë posedon edhe vulën e pranimit postar me datën dhe nënshkrim të debitorit dhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e menaxherit të kontratës. Vlen të ceket se sipas vlerësimit të gjykatës, vlerëson se pretendimet e debitorit në prapësim, sa i përket detyrimit janë të paqëndrueshme, andaj të njëjtin e refuzohet si të pa bazuar.

Po ashtu, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, që është në përputhje me dispozitën nga nenin 37 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, ku përcakton se, Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, pra dokumenti në fjalë fatura është dorëzuar në origjinal. Gjithashtu në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 01/2023 e datës 20.06.2023, ku me dispozitën e nenit 29 par. 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, përcaktohet paragrafi 1 se Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesën në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm sipas LPP-së. Ndërsa sipas paragrafi 3 përcaktohet se, Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin- fatura e cila paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta është treguar debitori, përkatësisht i njëjti përmbart të gjitha elementet të një besueshëm në kuptim të plotësisimit sipas neneve të lartëcekura nga LPP-ja, gjithashtu kjo faturë posedon nënshkrim e debitorit dhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e personit zyrtar. Po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, pajtohet në tërësi me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se ky dokument përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase i ka përmbartur kushtet ligjore nga neni 29 par. 1 dhe 3 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument e ka cilësinë e dokumentit përmbartimor në origjinal dhe është pranuar nga ana e debitorit, në mënyrë të rregullt duke e nënshkruar-pranuar me dëshmi e nënshkrimin të menaxherit të kontratës, prandaj konsiderohet e rregullt.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës kreditore, mirëpo të njëjtit i refuzuar si të pabazuar dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës. Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
K.Dh.shk.II.nr.1132/25, me datë 19.02.2026

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi

